

1. PËRSE DUHET NJOHJA E DIPLOMAVE TË FITUARA NË SHKOLLAT E LARTA TË HUAJA?

- Konventa e Lisbonës e përpiluar nga Këshilli i Europës dhe UNESCO, aprovuar më 8-11 prill 1997.
- Deklarat e përbashkët e Ministrave Europianë të Arsimit mbledhur më 19 qershor 1999.
- Ligji Nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) neni 43, që thekson se “Mënyrat e njohjes dhe të ekuivalentimit të certifikatave, diplomave dhe gradave të fituara në shkollat e larta të huaja bëhen me akte të Këshillit të Ministrave, duke respektuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë”
- U përgjigjet kërkesave të ligjshme, për njohjen e diplomave të huaja, të qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri.
- Plotësimi legjislacionit për të qenë në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit dhe me aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë ka aderuar, veçanërisht me Konventën e Lisbonës “Mbi Njohjen e Diplomave të Arsimit të Lartë në rajonin e Europës” në të cilën ka aderuar edhe vendi ynë.
- Njohje për qëllime akademike dhe për qëllime profesionale.

2. Pak histori

- Në sistemin europian të arsimit të lartë vepron ENIC prej vitit 1994, (European Network of Information Centre), si organ i Këshillit të Europës, anëtarë të së cilës janë NARIC (National Academic Recognition Information Centre) në çdo vend të veçantë. Detyra kryesore e NARIC është të njohë dhe ekuivalentojë diplomat dhe të shpërndajë informacion për sistemin e arsimit të lartë dhe nivelet e diplomave që lëshohen.
- Qendrat NARIC janë formuar prej ministrive të arsimit në çdo vend, por statusi dhe objekti i punës së tyre mund të jetë i ndryshëm nga një vend në tjetrin. Në vendet ku universitetet kanë një autonomi të fortë, vendimi për njohjen e kualifikimeve dhe periudhës së studimeve merret prej tyre për arsimimin e fituar jashtë shtetit. Në këto raste Naric nuk marrin vendim, por afrojnë informacion dhe këshilla për të gjithë të interesuarit.
- Në shumicën e rasteve këto qendra janë përgjegjëse për të bashkërenduar punën me Këshillin e Europës dhe UNESCO-n për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit. Rrjeti NARIC është i lidhur me rrjetin informativ të arsimit të lartë në Europë (EURIDICE) i cili përkrahet nga programi SOCRATES dhe me drejtori të Bashkimit Europian. Rrjeti NARIC kooperon edhe me Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) i krijuar më 1999.
- Në të gjitha vendet, Naric kryejnë këto funksione :
 - japin informacion për arsimin e lartë
 - përfaqësojnë shtetin në bashkimin Europian, Këshillin e Europës dhe UNESCO
 - japin vlerësime krahasuese për arsimin e lartë të huaj
 - publikojnë informacione, broshura, shërbime në internet
 - japin informacion për mundësitë e studimit dhe punësimit.

3. Disa mënyra të organizimit të zyrave NARIC në :

- Angli : NARIC punon me kontratë për Departamentin e Arsimit dhe Aftësive
- Danimarkë : quhet Qendra Daneze për vlerësimin e kualifikimeve dhe është pjesë e Ministrisë së Arsimit
- Qipro : Këshilli për Njohjen e Kualifikimeve
- Greqi : Qendra Ndëruniversitare për njohjen e niveleve të ndryshme dhe ekuivalencën e shkallëve të arritura në krahasim me institucionet greke
- Andorra : Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve
- Armeni : Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Australi : Zyra Kombëtare e Njohjes së Aftësive (NOOSR), në kontakt me Departamentin e Arsimit Shkencës dhe Trajnimit
- Ajzerbaxhan : Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Bjellorusi : Instituti Kombëtar për Arsimin e Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës
- Belgjikë : Qendra NARIC në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, pranë Departamentit të Arsimit
- Bullgari : Qendra Kombëtare e Informimit për Njohjen Akademike dhe Mobiliteteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, pranë Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë
- Kanada : Qendra e Informimit Kanadez për diplomat ndërkombëtare
- Kroaci : Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pranë Departamentit të Arsimit të Lartë
- Çeki : Qendra për Ekuivalencën e Dokumentacionit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Sporteve
- Finlandë : Bordi Kombëtar i Arsimit pranë Qendrës Ndërkombëtare për Mobilitetin, (aplikimet i dërgohen institucionit)
- Lituani : Qendra për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- Poloni : Këshilli i Fakultetit për diploma të ngjajshme. Për diploma të panjohura ose të diskutueshme i delegohen Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e cila krijon komisione
- Slloveni : pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Sporteve
- Maqedoni : pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Sporteve
- Turqi : Këshilli Kombëtar për Arsimin
- SHBA : Rrjeti i Shteteve të Bashkuara për Informacion për Arsimin, pranë Departamentit të Arsimit
- Itali : Kërkesat paraqiten tek rektori
- Rumani : Qendra Kombëtare për Njohjen dhe Ekuivalencën e Diplomave, Drejtori në Ministrinë e Arsimit Kombëtar

4. PROCEDURAT E NJOHJES SË DIPLOMAVE NË VENDIN TONË:

- Bashkëpunimi MASH-Universitet
- Niveli i parë dhe kualifikimet pasuniversitare
- Niveli master
- Doktoratura

5. ANËT E FORTA :

- Procesi ka filluar dhe është fituar përvojë
- Janë njohur 160 diploma
- Janë krijuar lidhje me homologët tanë të huaj

6. DHE TË DOBËTA:

- Mungesa e një qendre të mirëfilltë për njohjen e diplomave
- Personeli i pamjaftueshëm
- Mungesa e njohjes nga ana e publikut
- Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit
- Shpërndarje përgjegjësie për nivele të ndryshme njohjeje
- Mungesa e motivimit të stafit
- Vështirësi praktike të njohura (viza, kohë, para etj)por edhe të papritura (moskorrektë nga partnerë të huaj, etj).